

VENDIM
Nr. 245, datë 29.3.2017

**PËR DHËNIEN ME QIRA, ME TARIFË TË REDUKTUAR, TË SALLËS SË
KONCERTEVE TË PALLATIT TË KONGRESEVE, TEATRIT KOMBËTAR TË
OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 784 e 801, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, dhe në vijim të pikës 8, të kreut III, të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e dhënies me qira, me tarifë të reduktuar, të sallës së koncerteve të Pallatit të Kongreseve, Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor për zhvillimin e aktiviteteve të tij artistike deri në përfundim të rikonstruksionit të mjediseve të këtij teatri.
 2. Tarifa e qirasë së sallës së koncerteve do të jetë në masën ekuivalente të shpenzimeve operative të kryera respektivisht për çdo aktivitet, gjatë gjithë periudhës së dhënies me qira.
 3. Shpenzimet për pagesën e qirasë, sipas këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Kulturës.
 4. Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor dhe Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi